

DISLEKSIA, NJË PROBLEM SOCIAL NË MOSHAT SHKOLLORE DYSLEXIA, A SOCIAL PROBLEM IN SCHOOL AGES

Esmeralda BIRCAJ¹, Milika DHAMO², Virxhil NANO²

¹Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, Shqipëri

²Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale

Email: aldabircaj@hotmail.com

PËRMBLEDHJE

Duke u nisur nga motoja: "...fëmijët duhet të mësojnë të lexojnë, që më vonë të lexojnë për të mësuar...", shkak u bën komplikimet në të lexuar, shkruar, folur dhe shqiptuar të disa prej nxënësve në moshën shkollë.

Qëllimi i këtij kërkimi është vlerësimi i funksioneve bazë të implikuara në proceset e të mësuarit për të identifikuar para kohe faktorët e mundshëm të riskut në vështirësitë e të mësuarit të lexim/shkrimit.

Ky punim është rezultat i një kërkimi, zhvilluar gjatë diagnostikimit të disleksisë. Kërkimi në fushën e zhvillimit të proceseve kognitive përfshiu të mësuarit e lexim/shkrimit në 47 fëmijë të klasës së parë dhe të dytë që frekuentojnë shkollën fillore të arsimit jopublik të qytetit të Vlorës, në periudhën 2006-2008.

Prania e këtyre fëmijëve me vështirësi në këto procese më ka surprizuar mjaft. Ndaj fëmijët disleksikë kanë nevojë për trajtim në qendra të specializuara multidisiplinare me metoda të mësuari efektive, shumë-shqisore. Trajtimi duhet të jetë edukativ, nëpërmjet mësimesh të qarta, të organizuara, që përfshijnë të parët, të dëgjuarit, të bërët dhe të ndijuarit.

Fjalët kyçe: paaftësi në të mësuar, crregullim, vetëdije fonologjike, vetëbesim, shumëshqisore.

SUMMARY

Taking into consideration the motto "...children should learn to read, later read to learn..." a lot of children have complications when it comes to reading, writing, speaking and pronouncing material given in school.

The purpose of this research is to assess the basic functions involved in learning processes to help identify potential early risk factors in learning difficulties of reading and writing.

This study is the result of a search conducted during the diagnosis of dyslexia. Diagnosis of dyslexia usually

begins when a parent or teacher notices reading or comprehension failure. Research in the field of the cognitive processes involved the learning of reading/writing (literacy) to 47 children in the first and second grade to attend non-public, primary school education of the city of Vlora, during the period 2006-2008. Research is articulated in two phases. In the first phase are estimated children in the first grade. In the second class is made measure of the maturity level of reading and writing skills through standardized tests. This, gave us opportunities to diagnose (enabled the diagnosis), which can be a cognitive process to understand their abilities in order to learn and to put these skills to function.

The presence of these children with difficulties in these processes has surprised me a lot. Therefore, dyslexic children need treatment from centers that are specialized with multidisciplinary learning effective and multi-sensory methods. Treatment should consist of educational lessons through clear, organized, involving the visual, audible range and behavioral methods.

Key words: learning disabilities, disorders, phonological awareness, self-confidence, multisensory

Hyrje

Në vitet e fundit është verifikuar një shtim i fëmijëve që paraqesin vështirësi në procesin e të mësuarit në shkollë. Jo të gjitha vështirësitë dhe dështimet shkollë janë pasojë e mos të mësuarit, mospërqëndrimit, realizimit të dobët të detyrave dhe vajtjes me hope në shkollë. Disa, burimin e tyre e kanë tek crregullimet e gjuhës së shkruar. Ky term përmbledh **paaftësinë e fëmijës për të lexuar, shkruar dhe manipuluar me numrat**. Diagnostifikimi, zakonisht fillon kur një prind ose mësues shpall të lexuarit ose të kuptuarit dështim.

Ky mosfunksionim nuk është pasojë e një analfabetizmi ose e humbjes së aftësive shkollë ose mospërdorimi i

tyre, as edhe pasojë e deficienteve intelektuale, mendore ose sensoriale, por *“një çrregullim që lë në dinamikën psikike të fëmijës vetë procesi i të shkruarit”* (Marie Alice du Pasquit).

Qëllimi

Individualizimi i fëmijëve me risk, dhe vlerësimi i secilit proces konjitiv të implikuar në proceset e të mësuarit për të identifikuar para kohe faktorët e mundshëm të riskut në vështirësitë e të mësuarit të lexim/shkrimit.

Një diagnozë para kohe e deficienteve të tilla mund, sigurisht, të ndihmojnë shkollën dhe mësuesit në adoptimin e metodave të mësimdhënies së përshtatshme, dhe mund të bëjë më të kuptueshme për prindërit vështirësitë e fëmijës .

MATERIALI DHE METODA

Të mësuarit e lexim/shkrimit¹

Të mësuarit e lexim/shkrimit është objektivi kryesor i muajve të parë të shkollimit.

Stadeti e të mësuarit janë përcaktuar ,pikërisht, nga Frith(1985)dhe Seymour(1985). [6 & 8]

Modeli i përshkruar nga Uta Frith parashikon zhvillimin e shkrim/leximit në katër faza, të pavarura nga njëra-tjetra. Secili stad karakterizohet nga aftësimi për procedura të reja dhe nga konsolidimi dhe automatizimi i tyre, të fituara gjatë fazës.

1.Në fazën logografike (mosha parashkolllore) fëmija e konsideron shkrimin si një proces i prodhimit të logos. Ai, në fakt, nuk është i ndërgjegjshëm për lidhjen ndërmjet grafemës dhe fonemës. Në këtë fazë fëmija kërkon të imitojë veprimet motore të të rriturit gjatë shkrimit, imiton karakterin e dukshëm pikërisht, sic bën në fazat e para të të folurit, kur imiton prindërit. Strategjia e adoptuar nuk është fonologjike ,por grafike dhe ndryshimi ndërmjet vizatimit qëndron në faktin se nuk riprodhohen karakteristika fizike, por përdoren shenja konvencionale që fëmija ka zbuluar si tipike të atij aktiviteti të quajtur shkrim. Në këtë fazë mund të dallohen disa nënfaza:

- imitimi i gjestit të të shkruarit.Në këtë fazë fëmija riprodhon veprimet motore të shkrimtarit, duke imituar aktin e vazhdueshëm të shkrimit.Fjalët nuk diferencohen dhe fëmija ka pak shenja në dispozicion për të përsëritur.Pra, fëmija merr dhe riprodhon karakterin e dukshëm të një aktiviteti.

- shfaqja e shkronjave dhe pseudoshkronjave.Fëmija kërkon të riprodhojë shenjat që përdoren në gjuhën e

shkruar, jo më si imitim i sjelljes. Shenja të ndryshme shikohen akoma si ikona dhe jo si elementë simbolik.

- shkrimi prekonvencional standart, përfaqëson një evolucion të mëtejshëm të fazës logografike. Fëmija kërkon të manipulojë shenjat grafike (shkronjat) që di t'i riprodhojë në mënyrë autonome por, pa njohur vlerën sonore konvencionale. Fëmija fillon të kombinojë simbole të ndryshme në mënyra të ndryshme.

2.Në fund të sistemit parashkollor dhe me fillimin e shkollës fillore fëmija hyn në **fazën alfabetike**, në të cilën fillon të kuptojë lidhjen ndërmjet grafemës dhe fonemës ose vlerën sonore konvencionale të shkronjave. Sipas Uta Frith fëmija ka një strategji të shprehjes fonetike të fjalës ,që i lejon të riprodhojë me shkrim duke aplikuar rregulla të konvertimit fonemë-grafemë. Në këtë mënyrë, fëmija është në gjendje të shkruajë fjalët në të cilat, ka një lidhje biunivoke (njëkuptimesi) ndërmjet tingullit dhe shenjës, por jo të shkruajë fjalë që kanë fonema me lidhje grafemash komplekse.

3.Në fazën ortografike zhvillohen aftësi të ndryshme, të fituara në fazën e mëparshme dhe arrihet një zotërim më i madh në kodifikimin e fjalës mbasi kërkohet një tejkalim i strategjisë së analizës fonologjike e cila, duket inefficente për prodhimin e shumë fjalëve të leksikut tonë ortografik.

Faza ortografike kërkon një modifikim të strategjisë së përpunimit të informacionit. Fëmijët kuptojnë disa rregulla esenciale për leximin duke proceduar me rrokje dhe jo më me shkronja të vecanta. Përballja e shpeshtë me fjalët i lejon fëmijës të memorizojë format e tyre grafike duke i njohur më pas, në mënyrë automatike dhe të përgjithshme.

4.Kalohet kështu në fazën leksikore , në të cilën leximi i fjalëve me përdorim të zakonshëm është i shpejtë ndërsa, leximi i fjalëve dhe jofjalëve të reja realizohet duke përdorur strategji të fituara në fazën paraardhëse. Kjo fazë i lejon fëmijët të paraqesin në mënyrë korrekte elementët homofon, të cilët duhen paraqitur në mënyrë të ndryshme sipas kuptimit të tyre brenda frazës. Pra,ky nivel, lejon një segmentim korrekt të elementëve të frazës dhe përhap një strategji të re (leksikore) të domosdoshme për të shkruar një frazë të gjatë të të folurës së vazhdueshme(Cornoldi 1991, Frith 1985). Modeli i Frith , duke qenë një model me stade, hipotizon një vazhdueshmëri hierarkike të të mësuarit të leximit. Kjo do të thotë se ,nëse fëmija nuk ka arritur të përfitojë nga stadi logografik nuk do të jetë në gjendje të përfitojë nga kompetencat e stadi pasardhës.

¹ Stadeti e të mësuarit të përcaktuara nga Frith(1985) dhe Seymour (1985).




Figura 1 - Modeli i të mësuimit të leximit dhe shkrimit (Cornoldi-1991) [3]

Seymour përdor një skemë të tij (fig.1) ,shumë të ngjashme me atë të Frith, për të bërë një klasifikim të crregullimeve të ndryshme të leximit mbi bazën e tipit, e vëne re, kjo, gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit të leximit. [8] Autori vë në pah tipe të ndryshme të disleksisë evolutive.

Mikste (mix), në këtë rast crregullimi i leximit verifikohet si pasojë e një bllokimi në fazat e para të zhvillimit të stadi alfabetik.

Fonologjike (F) vjen nga bllokimi i zhvillimit të stadi alfabetik, karakterizohet nga një vështirësi në leximin fjalëve më pak të shpeshta ose të parregullta ose më saktë, ato fjalë, në të cilat injorohen rregullat e konverzionit grafemë-fonemë ose rregullat e vendosjes së theksit.

Siperfaqesore (S). Në këtë rast crregullimi i leximit vjen nga bllokimi në zhvillimin nga stadi ortografik në stadi leksikor. Simptomat e një deficiti të tillë janë vështirësia në leximin e fjalëve të parregullta dhe në diskriminimin e fjalëve homofone.

Proceset konjitive që përfshihen në të mësuimit e lexim/shkrimit.

Me termin funksione bazë i referohemi asaj bashkësie aftësish,ngushtësisht të lidhura me aspekte konjitive, perceptive dhe motore që, gjatë zhvillimit, arrijnë nivele kompleksiteti gjithmonë e më të mëdha, me të cilën aktivizimi bëhet gjithmonë e më shumë automatik dhe më pak i lidhur me kontrollin e vullnetit.

Komponentët bazë janë [2] [8]

a-rrokjezimi viziv. Aftësia e analizës graduale të grafemave duke proceduar në vazhdimësi nga e majta

në të djathtë. Kjo nënkupton një funksionim korrekt të të qenit i kujdesshëm.Shpesh,në rastet me disleksia lexuesi nuk arrin të bëjë një analizë vizive sipas radhës dhe si rezultat do të kemi lexim jo të saktë me kapërcim fjalësh ose rreshtash.

b- Analiza dhe dallimi viziv. Aftësia për të analizuar dhe dalluar në mënyrë të saktë trajtat e dallueshme ose orientimi dhe forma e grafemave në mënyrë që, të njihen nga njëra-tjetra. Kjo aftësi është shumë e rëndësishme në tekstet e shkruara me shkronja të vogla (p,q, b,d)

c- Kompetenca fonologjike ose aftësia për të analizuar tingujt, të ndarë nga njëri-tjetri. Pjesa më e madhe e fëmijëve 6-vjec arrin, në mënyrë spontane, të ndajë fjalët në rrokje por, jo të analizojë vecmas të gjithë tingujt e fjalës. Megjithatë shumica e fëmijëve, në fillim të klasës së parë ,janë në gjendje të njohin tingujt e njëjtë në fjalë të ndryshme ,mbi të gjitha ato që ndodhen në fillim të fjalës. Kjo aftësi mund të zhvillohet me ushtrime dhe është një kalim i detyrueshëm për të arritur përfaqësimin e vlerës konvencionale të tingullit.

d- Kompetenca fonografike ose aftësia për të vendosur në korespondence shenjat me tingujt,sjell ,jo vetëm të mësuarit përmendësh të shkronjave por, edhe aftësinë për të manipuluar me strukturat fonologjike, duke mbajtur në kujtesë ,për aq kohë sa është e nevojshme, për të gjetur shenjat koresponduese,pa e dëmtuar frazën. Edhe kjo kompetencë, si ajo fonologjike, arrihet gradualisht. (Stella, Pippo 1987)

Metodologjia

Për punën kërkimore u ndoq një proces sistematik diagnostikimi.Fëmijët i'u nënshtruan testeve të inteligjencës [7](Matricat progresive të Raven-it ,forma me ngjyra 1984) dhe testeve standard.

Studimi është artikuluar në dy faza.Në fazën e parë janë vlerësuar fëmijët në klasën e parë. Në klasën e dytë është bërë matja e nivelit të maturimit të aftësive të leximit dhe shkrimit përmes testeve të standartizuara.

Analiza e të dhënave

Për të vlerësuar fëmijët që nuk kanë arritur një nivel aftësimi të parakushteve,kam konsideruar fëmijë me risk ata që kanë dhënë rezultate të ulëta.

Testet e aplikuar në klasën e parë janë :

- Matricat progresive të Ravenit (format me ngjyra) për inteligjencën [7]
- Test për njohjen e shkronjave në fushën e perceptimit
- Test për memorjen fonetike,
- Test i shkrirjes fonetike për aftësitë metafonologjike

- Bender-test në fushën e integritimit vizivo-motor [2]

Analiza e parakushteve

Në tabelën 1 kam paraqitur rezultatet e marra pas aplikimit të testit të Ravenit.

Klasa e parë ka 23 fëmijë, prej të cilëve 12 janë femra dhe 11 janë meshkuj.

NUMRI I FËMIJËVE	IQ
1	70
4	72
10	75
4	76
3	78
1	82

Tabela 1- Testi i Ravenit Mesatarja : 75.5

Prova e njohjes së shkronjave

KA VËSHTIRËSI NË NJOHJEN E SHKRONJAVE	PO	JO
	3	20

Tabela 2 – Testi i njohjes së shkronjave

Memorja fonetike

KA VËSHTIRËSI NË MEMORIZIMIN E SHKRONJAVE	PO	JO
	1	22

Tabela 3 – Testi i memorjes fonetike

Segmentimi fonetik

KA VËSHTIRËSI NË NDARJEN E SHKRONJAVE	PO	JO
	0	23

Tabela 4 – Testi i segmentimit fonetik

Shkrija fonetike

KA VËSHTIRËSI NË FUZIONIMIN E SHKRONJAVE	PO	JO
	2	21

Tabela 5 – Testi i fuzionimit fonetik

Bender-test

KA VËSHTIRËSI NË KOPJIMIN E FIGURAVE	PO	JO
	3	20

Tabela 6 – Bender-test

REZULTATET

Më poshtë kam paraqitur fëmijët me risk për secilën provë

Raven	Njohja e shkronjave	Memorja fonetike	Segmentimi	Fuzioni mi	b-test
1	3	1	0	2	3




Tabela 7 – Përmbledhje

Sipas kësaj table, kam evidentuar tre fëmijë me risk, prej të cilëve 2-meshkuj, dhe 1-femër.

FËMIJË NË RISK	FËMIJË JO NË RISK
3	20

Rezultatet e testeve të aplikuara në klasën e dytë

Klasa e dytë ka 24-nxënës, prej të cilëve 14-femra dhe 10-meshkuj.

Provat e aplikuara janë:

- Prova e kuptimit të tekstit
- Prova e saktësisë
- Prova e leximit të fjalëve
- Prova e diktimit

Më poshtë kam paraqitur rezultatet e marra pas aplikimit.

NUMRI I FËMIJËVE	IQ
1	71
5	73
12	75
4	78
2	83

Tabela 1- Testi i Ravenit

KA VËSHTIRËSI NË KUPTIMIN E TEKSTIT	PO	JO
	1	23

Tabela 2 - Prova e kuptimit të tekstit

KA VËSHIRËSI NË LEXIMIN SAKTË TË TEKSTIT	PO	JO
	3	21

Tabela 3 - Prova e saktësisë

KA VËSHIRËSI NË LEXIMIN E FJALËVE	PO	JO
	2	21

Tabela 4 - Prova e leximit të fjalëve

BËN GABIME GJATË SHKRIMIT TË FJALËVE	PO	JO
	3	21

Tabela 5 - Prova e diktimit

Raven	Prova e kuptimit	Prova e saktësisë	Prova e leximit	Prova e diktimit
1	1	3	2	3

Tabela 6 - **Përmbledhje**(rezultatet e të gjitha provave).

Sipas të dhënave duket qartë se, tre fëmijë janë me vështirësi në të nxënë, prej të cilëve **evidentova 2-meshkuj dhe 1-femër.**

KONKLUZIONE

Në përgjithësi, studimi im ka nënvizuar se si, me hyrjen në klasën e parë fëmijët në risk shfaqin vështirësi të mjaftueshme në proceset bazë.

Duke kaluar në analizën e aftësive në klasën e dytë dhe zhvillimit të tyre, vura re një numër më të madh fëmijësh në risk për detyrat me shkrim, ndërsa për provat që vlerësojnë kapacitetin e leximit ka një numër më të madh fëmijësh në risk në leximin e fjalëve.

Prania e këtyre fëmijëve me vështirësi në këto procese më ka surprizuar mjaft. Përballë këtij fakti është e mundur të paraqesim dy hipoteza, nga njëra anë, mund të mendohet se, me fillimin e klasës së dytë këto aftësi nuk janë maturuar plotësisht, dhe nga ana tjetër, ky është rezultati i një ecurie shkollore, në të cilën përbërja e mësimdhënies nuk është e përshtatshme me nivelin real të zhvillimit të fëmijëve. Të dyja hipotezat nuk përjashtojnë njëra tjetrën, përkundrazi në realitet kompletohen.

Nëse konsiderojmë modelin e Uta Frith, fëmijët në këtë moshë gjenden në fazën ortografike të zhvillimit të aftësive, të lexim/shkrimit, në të cilën procesi i kodifikimit të informacionit modifikohet dhe procedohet në leximin me rrokje dhe jo më me shkronja. Kalimi nga njëra fazë në tjetrën është hierarkike, si pasojë, një vonesë në përfitimin e kompetencave të një fazë nuk lejon hyrjen në kohë në fazën tjetër.

Nuk duhet, sidoqoftë, nënvlersuar rëndësia e metodës së mësimdhënies, mbasi është e rëndësishme që, mësuesit të kenë kohë të përshtatshme për nivelin real të zhvillimit të fëmijës, dhe të favorizojnë mbi të gjitha, në klasën e parë, maturimin e parakushteve dhe të mësuarit e strategjive.



REKOMANDIME

Nevojë primare për t'u ardhur në ndihmë fëmijëve me crregullime në të nxënë për të lexuar dhe shkruar është ngritja e qendrave të specializuara multidisiplinare, me metoda të mësuarit efektive shumë-shqisore. Qendra të tilla duhet të kenë të përfshirë në stafin e tyre njerëz të specializuar si mësues të specializuar, psikologë, peditër, logopedë etj, të cilët, duke bashkërenduar punën e tyre do të jenë të aftë të trajtojnë dhe rikuperojnë apo zbusin sadopak këto crregullime tek fëmijët. Reabilitimi duhet të jetë: logopedik, psikomotor dhe psikoterapi.

“Nëse fëmija nuk mëson në rrugën që ne i mësojmë, ne do t'i mësojmë rrugën që ai mëson”- duhet të jetë motoja për trajtimin e tyre edukativ. [10]

Dislektikët kanë nevojë vecanërisht, për mësim të qartë, të organizuar dhe shumë- shqisor. Megjithëse, disleksia është neurologjike, e bazuar në crregullimin e të mësuarit, trajtimi është edukativ (mësimor).

Dislektikët kërkojnë mësim shumë shqisore që përfshijnë të parët, të dëgjuarit, të bërët, dhe të ndijuarit. Përdorimi i të mësuarit shumë-shqisor e ndihmon fëmijën të mësojë përmes më shumë se një shqise, gjithmonë duke u nisur nga motoja:

- Dëgjojmë, harrojmë
- Shohim, kujtojmë
- Bëjmë dhe kuptojmë.

Ndihma për dislektikun e cfarolloj moshe, mund të fillojë vetëm kur vështirësitë e tij janë vëzhguar, analizuar dhe identifikuar.

BIBLIOGRAFI

1. Anderson, V., Manly, T., Robertson, I.H., Nimmo Smith, I. (1999), Test of Everyday Attention of Children, London, Thames Valley Test Company

2. Arcolini, I. e Cardini, G., (2002), I disturbi di apprendimento della lettura e della scrittura, Milano, Fondazione P. e L. Mariani, ONLUS
3. Beery, KE e Buktenica, (1997), Test of Visual-motor Integration, Modern Curriculum Press
4. Cornoldi, C., (1991), I disturbi dell'apprendimento. Aspetti psicologici e neuropsicologici, Bologna, Il Mulino
5. Cornoldi, C. e Colpo, G., Prove di Lettura MT per la Scuola Elementare, (manuale), Firenze, Organizzazioni Speciali
6. Cornoldi C., Miato L., Molin A. e Poli S., (2000), PRCR-2. Prove di prerequisito per la diagnosi delle difficoltà di lettura e scrittura, (manuale), Firenze, Organizzazioni Speciali
7. Frith, U., (1985), Beneath the surface of surface dyslexia, in JC Marshall, M. Coltheart e K. Patterson (a cura di), Surface Dislexia and surface dysgraphia, London, Routledge and Kegan Paul
8. Raven, JC, (1984), Progressive Matrici Colorate, Firenze, Organizzazioni Speciali
9. Seymour, PH, (1987), Individual cognitive analysis of competent and impaired reading, in "British Journal of Psychology"
10. Bakker, Dirk J. "Neuropsychological Classification and Treatment of Dyslexia" Journal of Learning Disabilities Vol.25, Feb.1992:102-109.